



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM – ERZEN TIRANË

Nr 854 / prot
14

Tiranë më, 26 / 02 / 2018

VENDIM
Nr. 3 Datë 07.02.2018

PËR

SHTYRJEN E SHQYRTIMIT TË VENDIMARRJES PËR SUBJEKTET “LIM-EM” SHPK DHE “ASAB” SHPK DERI NË MARRJEN E MASAVE NGA GRUPI NDËRINSTITUCIONAL NGIRTUR ME URDHËRIN NR.228 DATË 01.12.2018 “PËR NGRITJEN E GRUPIT QËNDROR NDËR INSTITUCIONAL TË PUNËS DHE GRUPEVE VENDORE TË PUNËS PËR NDËRHYRJEN NDAJ SHFRYTËZIMIT DHE GËRRYERJES SË BRIGJEVE E SHTRETËRVE TË LUMENJVE” TË KRYEMINSTRIT DHE URDHËRIN NR.165 DATË 07.02.2017 “PËR NGRITJEN E GRUPIT VENDOR NDËR INSTITUCIONAL TË PUNËS NDAJ SHFRYTËZIMIT DHE GËRRYERJES SË BRIGJEVE E SHTRETËRVE TË LUMENJVE” TË PREFEKTIT TË QARKUT TIRANË

Në zbatim të ligjit 111/2012, të urdhërit Nr.228, datë 1.12.2017, “Për ngritjen e grupit qëndror ndërinstitucional të punës dhe grupeve vendore të punës për ndërhyrjen ndaj shfrytëzimit dhe gërryerjes së brigjeve e shtretërve të lumenjve”, të Kryeministrit, si dhe mbi bazën e Urdhërit Nr. 165 datë 07.12.2017, “Për ngritjen e grupit vendor ndërinstitucional të punës për ndërhyrjen ndaj shfrytëzimit dhe gërryerjes së brigjeve e shtretërve të lumenjve”, të Prefektit të Qarkut Tiranë, Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor” neni 4 pika 12, neni 7 pika 1, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 “Për miratimin e rregullores”, “Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor” Neni 11 pika 3, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen në mbledhjen e datës 07.02.2018

KONSTATOIM

Aktiviteti i subjekteve “Lim-Em” shpk dhe “ASAB” përkatësisht larje inertesh nga fraksionimi i gurit gëlqeror dhe prodhim betoni, aktiviteti i cili ushtrohet në brigjet e lumit Tërkuzë dhe Erzen është objekt kontrolli nga grupi vendor i punës për verifikimin e ndërhyrjes në brigjet e lumenjve. Për një vendimarrje të drejtë është e domosdoshme njohja me konkluzionet e grupit vendor dhe qëndror të punës të ngritur për këtë qëllim. Për këto arsye Këshilli i Basenit Ujor,

VENDOSI

1. Shtyrjen e shqyrtimit të vendimarrjes për kërkesat e subjekteve “Lim-Em” shpk dhe “ASAB” shpk, deri në konkluzionet përfundimtare të grupeve vendore dhe qendrore të punës.
2. Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit me mjetet e informimit publik dhe njoftimin e palës së interesuar.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Shpëtim MEDIU



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

